



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH. II.nr.809/2022

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitia Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të propozuesit të sigurimit B.I. nga Prishtina të cilin e përfaqëson Habib Hashani dhe Jeton Maqedonci avokat nga Prishtina kundër kundërshtarëve të sigurimit 1.....shpk nga Prishtina të cilën e përfaqëson A.B.A.M. shtetas Jordanez me adrese rruga A.M. fshatiKK Lipja, 2.....shpk nga Lipjani, dhe 3.A.B.M. shtetas Jordanez, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të sigurimit e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike I.E.K.nr.625/21 datës 24.03.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 28.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e propozuesit të sigurimit B.I. nga Prishtina, dhe VËRTETOHET Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.nr.625/21 e datës 24.03.2022.

A R S Y E T I M

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktvendimin e ankimuar IV.EK.nr.625/21 datës 24.03.2022, e ka Refuzuar si të pabazuar propozimin e propozuesit të sigurimit B.I. nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar të caktohet masa e sigurimit ndaj kundërshtarëve të sigurimit 1.....shpk nga Prishtina të cilën e përfaqëson A.B.A.M. shtetas Jordanez me adrese rruga A.M. fshatiKK Lipja, 2.....shpk nga Lipjani, dhe 3.A.B.M. shtetas Jordanez, ashtu që ti ndalohet kundërpropozuesve që të mos sigurojnë qfardo marveshje me palët e treta të realizojnë transaksione bankare blerje apo shitje pa pëlqimin paraprak të aksionarit të dytë B.I., të pezullohet kundërshtari i tretë A.B.M. nga pozita e drejtorit menaxhues të kundërshtarit të parëshpk-Prishtinë, derisa në mënyrë të plotfuqishme me vendim gjyqësor apo me marveshje midis palëve të vendoset sipas padis së propozuesit dhe kundërshtarve të sigurimit, me qëllim të vlersimit real dhe ruajtjes së vlerës së aseteve.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor, ankesë ka paraqitur i autorizuari i propozuesit të sigurimit, për shkak të shkeljes së dispozitave kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që gjykata e shkallës së dytë të ndryshoj aktvendimin e atakuar plotsisht apo pjesërisht ashtu që ndaj kundërshtarve të caktohen dhe të shqiptohen masa e domosdoshme për të evituar rrezikun për pasojat e dëmshme dhe dëmet konkrete që me veprimet e deritashme të

kundershtarve tashmë janë shkaktuar, që kjo gjykatë për të dytën herë jo të anuloi por të prish aktvendimin e dytë të shkallës së parë dhe qështjen ta kthej në gjykatën e shkallës së parë në rishqyrtim dhe në rivendosje. Gjykata e shkallës së parë nuk i ka zbatuar me konsekuence dispozitat e nenve 7.2 dhe 8 të LPK-së, vendimi është kundërthene dhe se aktvendimi bie ndesh me dispozitën e nenit 182 par.2 nën n) të LPK-së Gjykata e shkallës së parë thirret në fakte dhe prova të cilat janë të pakontestueshme por që kanë të bëjnë me procesimin e qështjes kryesore dhe që në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë mos caktimin e masës së sigurimit. Propozuesi në propozim dhe padi dhe në seanca dëgjimore ka prezantuar një mori faktesh dhe provash që e kanë bërë të besueshme dhe bindshëm jo vetëm ekzistimin e kërkesës dhe të drejtës subjektive të tij, si themelues si kontribues me vlerë shumfish më të madhe se kundershtari i dytë.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesi i sigurimit B.I. nga Prishtina, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me datën 28.09.2021, ka paraqit padi me propozimin e masës së sigurimit kundër të paditurve-kundershtarëve të sigurimit 1.....shpk nga Prishtina të cilën e ëprfaqëson A.B.A.M. shtetas Jordanez me adrese rruga A.M. fshatiKK Lipja, 2.....shpk nga Lipjani, dhe 3.A.B.M. shtetas Jordanez.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me propozimin e masës së sigurimit, në rivendosje, ka marrë Aktvendimin IV.EK.nr.625/21 datës 24.03.2022, me të cilin e ka Refuzuar si të pabazuar propozimin e propozuesit të sigurimit B.I. nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar të caktohet masa e sigurimit ndaj kundërshtarëve të sigurimit 1.....shpk nga Prishtina të cilën e përfaqëson A.B.A.M. shtetas Jordanez me adrese rruga A.M. fshatiKK Lipja, 2.....shpk nga Lipjani, dhe 3.A.B.M. shtetas Jordanez, ashtu që ti ndalohej kundërpropozuesve që të mos sigurojnë qfardo marveshje me palët e treta të realizojn transaksione bankare blerje apo shitje pa pëlqimin paraprak të aksionarit të dytë B.I., të pezullohet kundërshtari i tretë A.B.M.A. nga pozita e drejtorit menaxhues të kundërshtarit të parëshpk-Prishtinë, derisa në mënyrë të plotfuqishme me vendim gjyqësor apo me marveshje midis palëve të vendoset sipas padis së propozuesit dhe kundërshtarve të sigurimit, me qëllim të vlersimit real dhe ruajtjes së vlerës së aseteve.

Në arsyetim të këtij vendimi gjykata e shkallës së parë referohet në dispozitat e nenit 297.1 të LPK-së, dhe faktit se nga pjesmarrja në përqindje të aksioneve të Kompanis përcaktohet edhe vëllimi i të drejtave të aksionarit, në proporcion me pjesmarrjen në aksione, duke respektuar edhe vendimet e organeve të Shoqëris të marra nga shumica e antarëve. Në rastin konkret asnjëri nga kushtet ligjore nuk janë plotsuar për caktimin e masës së sigurimit.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të propozuesit se aktvendimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Dhomës së Shkallës së Dytë, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Dhoma e Shkallës së Dytë nuk i konsideroi si të bazuara pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë në asnjë mënyrë nuk e arsyeton mos caktimin e masës së sigurimit.

Në raport me këto pretendime ankimore Dhoma e Shkallës së Dytë konstaton se në arsyetimin e Aktvendimit të atakuar, në mënyrë të qartë janë dhënë kushtet ligjore që duhet përmbushur për caktimin e masës së sigurimit dhe në anën tjetër janë dhënë arsye të mjaftueshme sa i përket autorizimeve vendimmarrse të organeve të Shoqëris Tregtare.

Sipas vlerësimit të Kolegjit të Dhomës së Shkallës së Dytë, përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që nga shqyrtimi i çështjes janë plotësuar në mënyrë komulative kushtet e përcaktuara me dispozitat e nenit 297 par.1 pika (a) dhe (b), e të cilat i referohen besueshmërisë së kërkesës apo të drejtës subjektive dhe ekzistimit të rrezikut se pa caktimin e masës së tillë propozuesit do të mund ti pamundësohej apo vështirësohej dukshëm realizimi i kërkesës, andaj në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar propozimin për caktimin e masës së sigurimit.

Përfundimisht, Dhoma e Shkallës së Dytë e ka pranuar vlerësimin dhe përfundimin e shkallës së parë, pasi që gjykata e shkallës së parë, i ka vlerësuar vetëm rrethanat nga të cilat gjykata mund të nxjerrë besueshmërinë e kërkesës apo të drejtës subjektive, dhe në këtë rast nuk mund të ndikohet në mënyrën e menaxhimit dhe zhvillimit të aktivitetit afarist të Shoqëris Tregtare.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 194, 208 dhe nenit 209 pika (b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.809/22 datë 28.09.2022

Kryetari i Kolegjit – gjyqtari
Krenar Berisha